



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 10

Datë: 28. 04. 2017, ora: 12:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Nenad Rikallo, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC.

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
 2. Shqyrtimi i ftesës për monitorimin e zgjedhjeve në Republikën e Kroacisë;
 3. Shqyrtimi i vizitës në ACEEEO në Budapest
 4. Të ndryshme
-

1.Hyrje

Mbledhja, është udhëhequr nga kryetarja znj. Valdete Daka.

Valdete Daka: Përshëndetje. Ndoshta kjo mbledhje ju duket shpejt e thirrur, ngase ne patëm dje takim, mirëpo dje mbetëm te pika lidhur me pjesëmarrjen në vëzhgimin e zgjedhjeve në Kroaci. Nëse duam që të marrim pjesë, duhet ta kemi parasysh çështjen e vizave. Bëhet fjalë për zgjedhjet lokale, që do të

mbahen me 21 maj dhe, është afat i shkurtër prandaj, duhet me vepruar pak më herët. Pra, duhet të komunikojmë me ambasadën kroate, dhe me KQZ-në kroate. Po ashtu, mbasi që e caktuar mbledhjen, kemi parasysh edhe ACEEO-në lidhur me komunikimin me ta për trajnimet. Meqë, jemi anëtarë, ne mund t'i shfrytëzojmë programet e tyre të trajnimit. Pra, duhet të vendosim komunikim dhe, ne ta vazhdojmë bashkëpunimin dhe dikush nga ne të shkojë lidhur me vendosjen e kontakteve që ne t'i shfrytëzojmë programet e tyre të bashkëpunimit.

Po ashtu, ne kemi marrë një ftesë nga KQZ e Maqedonisë, tha znj. Daka lidhur me një takim pune në mes të Sekretariatit tonë dhe, Sekretariatit atje. Propozoj që, edhe kjo ftesë të hyjë në rend dite...

Betim Gjoshi: Kam edhe unë një propozim. Ne, dje biseduam lidhur me pagesën për AWEB dh e ACEEO. Nëse janë gati materialet, ta marrim një vendim. Sepse, financat pa vendim nuk mund ta bëjnë pagesën.

Valdete Daka: Shumë e drejtë. Unë, ua kam përcjellë imellin...

Ilri Gashi: Po, pajtohem me propozimin e Betimit dhe është mirë që të hyjnë të dyjat, por edhe është mirë që shkresat që vijnë duhet t'i dimë ne. Pra, duhet edhe ti trajtojmë...Unë, tash po njoftohem...Jam pro që kjo të hyjë në rend dite.

Enis Halimi: Kjo për Maqedoninë, kam menduar që të hidhet në këshill, ta diskutojmë dhe të silllet në mbledhje të KQZ, kurse nuk bëhet fjalë për fshehje ose tjetër gjë...

Valdete Daka: Nëse pajtoheni, le të futen në rend dite pagesat për ACEEO dhe AËEB. Dhe, shqyrtimi i ftesës për takim në Maqedoni. Kush pajtohet lidhur me këtë rend dite...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan unanimisht rendin e ditës të kësaj mbledhje.

2. Shqyrtimi i ftesës për monitorimin e zgjedhjeve në Republikën e Kroacisë

Valdete Daka: E keni ftesën e përkthyer, e cila është bërë nëpërmes të ACEEO-së! Janë edhe formularët që të plotësohen, formularët për vëzhgues. Pra, meqë ne jemi anëtarë të barabartë në ACEEO, ne participojmë si anëtarë të barabartë në ftesën e KQZ të Kroacisë e cila, u është dërguar të gjithë anëtarëve të ACEEO. Ne, tha znj. Daka, jemi vëzhgues ndërkombëtar dhe ne, deri më 17 maj, duhet të përgatitemi.

Nëse, në ndërkohë nuk na bëhen punët, nëse eventualisht kemi zgjedhje, nuk shkojmë por tani e shoh se, tash për tash kemi interesim...

Betim Gjoshi: Ne duhet të shohim se sa vetë do të shkojmë, dhe sa kohë të qëndrojmë. Pra, duhet t'i saktësojmë këto përmes vendimit tonë...

Binak Vishaj: Konkretisht, të diskutojmë...! Personalisht, mendoj që mund ta zvogëlojmë kohën, dhe të shkojmë të gjithë...

Ilir Gashi: A po shkojmë dy grupe: dikush në Kroaci, dhe dikush në Bukuresht, apo po duam të shkojmë...

Binak Vishaj: Personalisht, unë jam i interesuar me shkuar në Kroaci, kurse kushdo që ka preferencë tjetër për të shkuar në Bukuresht.

Bajram Ljatifi: Duhet të kemi kriterium, të shohim kush - ku ka qenë...!

Ilir Gashi: A ka dikush që shpreh interesim për në Budapest...?

Valdete Daka: Unë, në Kroaci nuk do të vi...! Kush vjen me mua në Budapest...?

Betim Gjoshi: Në Budapest, nuk mund të shkojmë të papërgatitur, sepse atje duhet të shkojmë me projekte, ti shfrytëzojmë mundësitë e bashkëpunimit...Të shkojmë në Kroaci, të gjithë...

Ercan Spat: Po më duket se të gjithë janë të interesuar me shkuar...

Valdete Daka: Shkojmë prej datës: 19 - 21 maj 2017. Por, të diskutojmë edhe për ACEEO...

Sami Hamiti: A do të vjen ndokush edhe nga Sekretariati...? Mbasi që janë tre automjete...Së paku një...!

Valdete Daka: A të vendosim edhe për Bukuresht tani...? Atje, shkojnë më së paku tre veta, por mundemi me qenë edhe katër persona. Ky është udhëtim në gusht, sepse atje mbahet Asambleja Gjenerale...

Adnan Rrustemi: A për Bukuresht a, Budapest...?

Valdete Daka: Aha, në Bukuresht shkoj unë me kryeshefin, dhe, s'di a duhet edhe ndokush tjetër me ardhë...!

Valdete Daka: Unë, në Kroaci nuk po shkoj, dhe atje të shkojnë dy nga Sekretariati. Ose, mund të vij edhe Kreshniku në Budapest. Pra, duhet dikush nga sekretariati...

Valdete Daka: Sa në Budapest...? Më së shumti 3 (2+1): Kryeshefi ose Kreshniku.

Betim Gjoshi: Nëse kryeshefi nuk shkon në Kroaci, shkon në Budapest...edhe pikë...

Valdete Daka: Kush vjen me mua në Budapest...? Prej 15 - 17 maj. Kurse, në ndërkohë vendosim se sa persona do të shkojnë në Bukuresht...!

Betim Gjoshi: A po vendosim edhe për në Shkup...?

Sami Hamiti: A është për Sekretariat...? Në parim e përkrahim dhe, s'kemi cka...

Ilir Gashi: Zëdhënësi, a po vjen në Kroaci, apo në Budapest.

Valdete Daka: Mendoj se në Bukuresht, ndoshta zëdhënësi mund të vjen...sepse, atje ka rëndësi që ai të shkoj...sepse, aty mund ta përcjellë së afërmi konferencën...

Betim Gjoshi: Nuk e kemi Bukureshtin në agjendë sot...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan unanimisht vëzhgimin e zgjedhjeve lokale në Kroaci, dhe vizitën e punës në Budapest.

Sami Hamiti: T'i shohim edhe këto pagesat për ACEEO dhe AWEB.

Binak Vishaj: Krye shefi, nuk ka asnjë pengesë për t'a paguar. A është shuma...?

Sami Hamiti: Ta marrim një vendim, dhe s'kemi çka tjetër...! Pastaj, krye shefi vepron..

Anëtarët e KQZ-së, miratuan pagesën për ACEEO dhe AËEB

Valdete Daka: Edhe një çështje: Për çdo vit, mjetet për trajnime që janë të dedikueme për trajnime, vazhdimisht na kthehen në buxhet. Sa po vërej, stafi ynë nuk po ndjek asnjë trajnim profesional, veç atyre trajnimeve që organizohen nga IFES-i, OSBE. Por, nuk ka trajnime me iniciativë të Sekretariatit...

Ilir Gashi: Edhe njëherë për zëdhënësin...Ai, po mbetet pa udhëtuar, dhe mandej as në Sekretariat nuk po shqyrtohet udhëtimi i tij, e as me ne...! Disi, po mbetet anash...

Valdete Daka: Jo, në Bukuresht është me interes të vij...

Ilir Gashi: Po, edhe në Maqedoni, është në interes me shkue...

Enis Halimi: Ne, jemi munduar që ta trajnojmë stafin, aq sa kemi pasur mundësi. Vitin e kaluar, kemi pasur një projekt prej 16 - 17 trajnime. Kurse, në ftesat që vijnë, ka edhe ftesa komerciale...Por, një çështje që desha të ngrisë, është edhe çështja e diskutimit të aplikacionit për votim jashtë Kosovës, por nuk na ka mbetur kohë...dhe, na duhet një vendim...!

Betim Gjoshi: Ka komercializim, por është ideja e juaj se, si ju duhet t'i ngrisni kapacitetet. Ju dini, nëse keni nevojë, për fushat e caktuara...! Edhe ato janë të nevojshme, por duhet konkretisht, dhe jo trajnime jo adekuate...Po, janë kthyer mjetet në fund të vitit, nuk janë shfrytëzuar dhe janë kthyer në buxhet, pra nuk janë aloku...

Sami Hamiti: Shumica u thanë, por ofertat e ndryshme komerciale, po...ama, që ka nevojë me u profesionalizue -trajnuet ky sekretariat, po ka shumë, shumë...Duhet me u ngritë kapacitetet, pra mos me ardhur vërejtjet...Te prokurimi dhe te financat, ndodhin problemet. Qoj, se ka nevojë me u ngritë kapacitetet...Ama, mundësitë me u identifikue ku janë mangësitë, patjetër...Njësitë kërkuese, nuk din me i shtruar kërkesat, ka shumë, shumë mangësi...

Ilir Gashi: Po, gjithçka është komerciale, por janë kompani të licencueme, dhe ka njerëz eminent që ligjërojnë, si për financa, prokurim etj. Nuk mund t'i injorojmë, por mendoj që ka kompani serioze...

Adnan Rrustemi: A e kemi një dokument të IFES-it për vlerësim, identifikim të nevojave për trajnime...?

Enis Halimi: IFES e ka bërë një plan së bashki me ne, dhe ka bërë intervista me secilin...Identifikimi ka ardhë nga poshtë, dhe ne kemi pas trajnime bazike, shumë profesionale, të ngushta...në kuptim profesional...Por, problemi është se, ku të duash me të dërguar, nëse nuk do të mësosh, kot është...

Sami Hamiti: Për këtë, shkon në shtëpi...!

Eshref Vishi: është një veprim procedural në duart e krye shefit...Në momentin kur bëhet vlerësimi i secilit punonjës, është një rubrikë që, eventualisht ka nevojë për ngritje të kapaciteteve profesionale. Këta, po thonë që i kanë bërë këto. Këta, e kanë një plan të trajnimeve...

Valdete Daka: E kemi një kërkesë nga krye shefi...?

Enis Halimi: Unë, vetëm ua përkujtova...!

Adnan Rrustemi: Nëse kemi vullnet me e diskutuar, mirë, por jam që të diskutohet...! Unë, e kam dhënë qëndrimin tim...

Eshref Vishi: E lëmë për një mbledhje tjetër.

Ercan Spat: Të martën kemi edhe një takim me stafin e BE-së...

Valdete Daka: Ne, po të martën e kemi takimin në ora 9.30 nga BE, janë ekspertë të cilët do ti vëzhgojnë zgjedhjet lokale...

Betim Gjoshi: është me rëndësi që ne, kemi nevojë për vëzhgim afatgjatë dhe jo vetëm në zgjedhje. Mirë është që ta kemi një person kontaktues. Unë, i kam lexuar raportet e tyre: ka gjëra të vërteta, por ka edhe mangësi, ka mungesë informacioni...S'janë subjektive, por ka mangësi komunikimi...mirë është të mbajmë kontakt të vazhdueshëm...ODIRI, nuk do të na monitoroj, dhe kjo është me rëndësi që ky mision t'i vëzhgoj zgjedhjet dhe është mirë që ta kemi një person kontaktues...

Ilir Gashi: Po dua me e ditë faktin se, ku kanë mbetur konstatimet e punëtorisë që i kemi pasur në Tiranë...! Kemi qenë katër ditë, kemi bërë punë dhe s'dim se çka ka ndodhur me konkluzionet...! Le të sillen...Çka ka ndodhur me ato rregullore, kur kryhen, a janë kryer apo...?

Sami Hamiti: Unë, dua t'i kemi dhe t'i lexoj ngadalë - ngadalë...Dua ti shohë, sepse ka edhe çështje të besimit, pra dua t'i shoh...

Betim Gjoshi: Rregulloret nuk kanë qenë për ne! Ne, kemi shprehur dëshirë dhe vullnet me e shtyrë përpara avancimin e Sekretariatit. Dikush, po mundohet me i shitë si punë të interesit personal, dhe jo të institucionit. Këta, duhet të kenë konsensus me e que përpara fuqinë e Sekretariatit...Nuk duhet me e pa institucionin "qysh jam unë"!

Ne, tha z. Gjoshi, atë që e kemi bërë e kemi bërë si KQZ me e avancuar Sekretariatit, dhe me i heqë disa pengesa që këta po thonë që i kemi...! Epo, s'kemi zyrtar komunal të zgjedhjeve në Drenas...Nuk e kemi të plotësuar vendin, po edhe vende të tjera...Ne, i kemi ndërruar rregulloret, e tash nuk janë përfunduar...Shih, ne po flasim për avancim, e si kemi vendet vakante të plotësuar...

Valdete Daka: Tash, rregulloret nuk po përfundohen. Pozitat nuk po plotësohen, e ne po hyjmë në zgjedhje...ndoshta, hyjmë edhe në zgjedhje të përgjithshme...Kanë thënë që kemi pengesa, e tash...çka po ndodh...?

Ilir Gashi: Jo, kemi edhe vendime për këtë punë...! Jemi akorduar që duhet me u trajtuar, kanë ardhur nga sekretariati ato dokumente...

Valdete Daka: Jo bre, janë shpenzuar 15 000 euro...!

Ilir Gashi: Po, i kemi ndërtuar dhe miratuar ato rregullore...të paktën, kemi shpenzuar 20 000 euro, kemi përgjegjësi edhe ne: kemi shpenzuar mund, i kemi ndërtuar rregulloret, kemi marrë vendim...

Enis Halimi: Jo, është proces që po punohet. Grupi po punon: si kemi lënë anash, është material voluminoz...

Betim Gjoshi: Propozimi për atë punëtori, ka buruar nga Sekretariati. Ne si KQZ, kemi pasur të merremi me rregulloret tona...E dyta: ka pasur shpenzime, përndryshe kemi pasur aq drafte të dobëta, të ngjashme me njëra tjetrën, të kopjuara...disa të marra nga Omudspersoni dhe Prokuroria...unë, do të kisha hequr dorë nga punëtorja dhe, do isha kthyer menjëherë...!

Veç, ato rregullore duhet të sillen. Përgjegjës, është sekretariati. Këta kanë kërkuar punëtori, dhe këta po i vonojnë...a po bëjnë pazare, apo si...! Sillni, dhe do ti miratojmë dhe pikë...

Valdete Daka: Kur do ti sillni...? Pozitat nuk po plotësohen: janë bërë qe katër vite e një muaj...Janë katër pozita, është shtuar edhe një...

Betim Gjoshi: Jo, janë gjashtë pozita...

Valdete Daka: Këta, s'po merren vesh mes vete për paga, koeficiente...

Sami Hamiti: Qysh s'po merren vesh...çka ka mu marrë vesh për konkurs...!

Valdete Daka: A kemi shans me i pa këto rregullore të përfunduara...?

Enis Halimi: Edhe një takim është dhe, do të sillen...

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
